

Bio - Drita Nosi

Drita Nosi mban pozicionin e Drejtueses së Drejtorisë Ekonomike dhe Burimeve Njerëzore pranë Këshillit të Lartë të Prokurorisë, që prej muajit Gusht 2023.

Ajo është diplomuar në vitin 2006 për Administrim Biznesi, pranë Fakultetit Ekonomik, Universiteti 'Aleksandër Xhuvani', si dhe ka përfunduar Master në Marketing në vitin 2014, pranë Fakultetit Ekonomik, në Universitetin e Tiranës.

Zonja Nosi ka një eksperiencë të gjatë në fushën e menaxhimit dhe financave, si në sektorin publik ashtu dhe në atë privat.

Nga viti 2007-2009 është angazhuar pranë Bashkisë Elbasan, ndërsa nga viti 2010 - 2014 pranë Union Bank Sh.a, Tiranë.

Gjatë periudhës 2014 - 2021 është bërë pjesë e administratës pranë Ministrisë së Financave, ku ka mbuluar kompetenca të ndryshme financiare.

Ajo është njohëse e dy gjuhëve të huaja, Anglidht dhe Italisht. Nga viti 2020 e në vazhdim, është pedagoge me kohë të pjesëshme, pranë Fakultetit Ekonomik, Universiteti i Tiranës.

Zonja Nosi është bërë pjesë e Këshillit të Lartë të Prokurorisë, në Mars 2021, ku ka mbajtur pozicionin e Përgjegjës të Sektorit të Financave.